



#WomeninEnergy

Women in Energy

Mbi një milion dollarë ndahen për 28 bursistet

Përmes programit 'Gratë në Energji', 28 vajza dhe gra kosovare kanë përfituar bursa të plota studimi në Amerikë në fushat e nevojshme për sektorin energjetik të Kosovës. Këto bursiste do të jetojnë dhe studiojnë në qytetin Des Moines dy vitet e ardhshme, duke u fokusuar në studime të shkencës, teknologjisë, makinerisë dhe inxhinierisë.

"Gratë në energji" është implementuar nga Fondacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK), ndërsa është financuar nga agjencioni federal amerikan Korporata e Shtadave të Mileniumit (MCC).

Bursistet kosovare janë përzgjedhur pas një procesi rigoroz të aplikimit ku kanë marrë pjesë 169 kandidatë të cilat janë testuar në anglisht, testim të njohurive mekanike dhe duke kaluar në intervista të monitoruara nga ekipet e ekspertëve amerikanë dhe kosovarë. Lëndët që këto vajza dhe gra do t'i studiojnë janë në harmoni me nevojat e zhvillimit të sektorit energjetik—si teknologjia e turbinave të ajrit, menaxhimi i termocentraleve, ndërtimi i paneleve solare, menaxhimi i ujërave në energji, teknologjia e informacionit, eficaenca energjetike, etj.

Sean Cairncross, drejtori i ri i sapoemëruar i MCC, për këtë program bursash ka deklaruar se "adreson një nga faktorët kyç që po pengojnë zhvillimin ekonomik të Kosovës—mungesën e grave në tregun e punës, sidomos në fushat si energjia. Fuqizimi i mundësive ekonomike për gratë është prioritet rëndësor për MCC që synon zvogëlimin e varfërisë nëpërmjet rritjes ekonomike. Programi i bursave 'Gratë në Energji' luan një rol të rëndësishëm të mundësojmë këtë".

Kongresmeni amerikan Eliot Engel, që njëkohësisht është edhe kryetari i Komisionit për Politikë të Jashtme në Kongres, deklaroi: Ky program bursash i MFK dhe MCC është investim i duhur në shkencë,

teknologji dhe fusha të rëndësishme për zhvillim të Kosovës, dhe se gratë fituese të bursave do të bëhen lideret e së ardhmes në Kosovë".

Petrit Selimi, drejtori ekzekutiv i MFK, fondacionit që implementon grantet amerikane të MCC, ka thënë të jetë "ndër aktivitetet e para konkrete që po shpërfaqen në publik dhe njëkohësisht ndër më të rëndësishmet sepse investon në arsimimin dhe krijimin e lideritshpirt të grave në sektorët e rëndësishëm ekonomik si energjia."

"Në energji, sot mbi 92% të punësuarve janë burra. Ne synojmë që nëpërmjet programeve të ndryshme, t'a rrisim pjesëmarrjen e grave në këtë sektor." - ka shtuar Selimi.

Programi i bursave "Gratë në Energji" është aktivitet i dizajnuar dhe implementuar nga Fondacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK), entiteti përgjegjës për implementimin e Programit të Pragut të nënshkruar në mes të SHBA—ve dhe Kosovës më 2017, e që mundëson investime prej 49 milionë dollarësh në projekte të rëndësishme për Kosovën, si sektori i energjisë së ripërtërishe që do të mbështetet nëpërmjet garancioneve bankare, eficaenca energjetike, eficaenca së sistemit të ngrohjes qendrore apo ai transparencës qeveritare nëpërmjet garave sfiduese në Open Data.

Fondacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK)

Ndërtesa Qeveritare (ish Banka e Lubjanës)

Migjeni 21, Kati 9
10000 Prishtinë, Kosovë
millenniumkosovo.org/
womeninenergy

